



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.56/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hidajete Gashi Alaj kryesuese, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura në 28 dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 30.12.2025, merr këtë:

VE N D I M

I.PRANOHET e BAZUAR ankesa ZP.Anr.56/2025 e datës 29.12.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë.

II. Subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë. për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit me datë 28.12.2025, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 1,000 euro (njëmijë euro).

III. Detyrohet Subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datën 29.12.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë Subjektit Politik AAK, në të cilën pretendon se më datë 28.12.2025, në ditën e heshtjes zgjedhore të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, zyrtarja e subjektit politik LVV, Vlora Vuçitërna, e cila njëkohësisht është edhe asamblistë e këtij subjekti në Kuvendin Komunal të Rahovecit, në ditën e zgjedhjeve ka publikuar një fotografi në rrjetin social Facebook gjatë kryerjes së votimit, të shoqëruar me mbishkrimin “ *Unë nuk lëshoj pe!*”, duke përdorur kështu sloganin zyrtar të fushatës së LVV-së për këto zgjedhje, e që është “ *Mos lëshoj pe*”. Dispozita e nenit 8, par.1, nënpar.1.5 i Rregullores Zgjedhore 07/2024 : *Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u*

*ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë: 1.5. shfrytëzimi i mediave lokale ose ndërkombëtare dhe rrjeteve sociale me qëllim të ndikimit tek votuesi.*

Me tutje në ankesë ka theksuar se, në rastin konkret, nga përmbajtja e fotografisë së publikuar vërehet qartë se Vlora Vuçitërna gjendet brenda Qendrës së Votimit, gjatë kryerjes së aktit të votimit, ndërsa publikimi i fotografisë shoqërohet me slogan politik që identifikohet drejtpërdrejt me subjektin që ajo përfaqëson. Sipas ankuesit, ky veprim përbën shkelje të hapur të heshtjes zgjedhore, për me tepër përmbajtja e postimit me sloganin e LVV-së, paraqet mesazh të qartë mobilizues dhe propagandues në favor të subjektit politik që ajo përfaqëson. Si prova, parashtuesi i ankesës ka bashkangjitur e zyrtares së lartcekur me datë 28.12.2025 dhe posterin e saj si kandidate për asamblistë. Andaj, bazuar në këto rrethana, parashtuesi i ankesës kërkon nga PZAP ta pranojë si të bazuar ankesën dhe në pajtim me ligjin e aplikueshëm ta shqiptoj sanksionin e miratuar.

Në përgjigje në ankesë, subjekti politik LVV ka theksuar se, ankesa e parashtuar bazohet në një interpretim të pasaktë dhe të zgjeruar të nocionit të fushatës zgjedhore gjatë ditës së votimit, duke barazuar në mënyrë të pajustificuar një shprehje të zakonshme gjuhësore me veprim propagandues zgjedhor. Tutje, në përgjigje sqarohet se vetë fakti që sloganin zyrtar i LVV-së është “Mos lësho pe!” nuk e bën automatikisht çdo përdorim të shprehjes “ unë nuk lëshoj pe” veprim fushate zgjedhore. Shprehja në fjalë përbën frazë të gjuhës së përditshme, e cila nuk përmban thirrje për votim, orientim elektoral apo mesazh mobilizues të drejtpërdrejtë dhe si e tillë nuk mund të barazohet me propagandë zgjedhore vetëm mbi bazën e ngjashmërisë semantike me sloganin e tyre. Sipas tyre, publikimi i referuar nuk përmban asnjë thirrje eksplicite për votim, përmendje të drejtpërdrejtë të LVV-së e as orientim elektoral ndaj votuesve në ditën e votimit dhe se vetë prania në qendrën e votimit dhe shprehja personale e një qëndrimi individual, pa veprim propagandues aktiv, nuk përbën shkelje zgjedhore dhe nuk mund të trajtohet si fushatë gjatë heshtjes ligjore, andaj kërkojnë nga PZAP që ankesën e parashtuar të hedhet si e pabazuar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, ankesës së ankuesit, përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik LVV, vlerësoj se pretendimet e subjekti politik AAK janë të bazuara dhe si të tilla i aprovoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 37 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet. *”Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë: 1.1 shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, dhe oborri i së njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi te votuesit; 1.2. bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.* Po ashtu me dispozitën e nenit 8, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 i Rregullores 07/2024, është paraparë që: *“Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë: 1.5. shfrytëzimi i mediave lokale ose ndërkombëtare dhe rrjeteve sociale me qëllim të ndikimit tek votuesi”.*

Paneli, konform nenit 13 par. 7 të Rregullores Nr. 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, me të cilin parasheh "Paneli para se të vendos lidhur me ankesën mund të kryej hetim nëse e konsideron të nevojshme dhe të arsyeshme." Andaj Paneli ndërmori hetim lidhur me pretendimet e përgjigjes në ankesë të subjektit politik LVV dhe gjeti se e ankesa nga subjekti politik AAK është e bazuar, pasi që nga hulumtimi dhe verifikimi në rrjetin social Facebook shihet se zyrtarja dhe asambleistja, ka bërë publikimin në rrjetin social Facebook me mbishkrim në mbështetje të subjektit politik LVV me datë 28 dhjetor 2025 në ora 11:00 minuta kështu duke shkelur rregullat për heshtjen zgjedhore në ditën e zgjedhjeve.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse", Paneli vlerësoj se pretendimet në ankesë janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se veprimi i përshkruar në ankesën e parashtruar është në kundërshtim me dispozitat e nenit 37 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 i Ligjit NR.08/L-228 dhe nenit 8 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Rregullores zgjedhore 07/2024. Në rastin konkret Paneli vlerëson se postimi i fotografisë në rrjetin social Facebook në ditën e zgjedhjeve në vendvotim me mbishkrimin "*Unë nuk lëshoj pe!*" dhe sllogani i subjektit politik LVV kanë përmbajtje dhe kuptim të njëjtë dhe për Panelin nuk paraqet dilemë se bëhet fjalë sloganin e subjektit politik dhe paraqet shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët në ditën e votimit, që do të thotë se veprimi i të njëjtës bie në kundërshtim me nenin 37, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, pasi veprimi është bërë në vendvotim e që ka për qëllim ndikimin tek votuesit.

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysht të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes si dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, kjo për faktin se subjekti politik LVV ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të votimit.

Paneli ka vlerësuar edhe përgjigjën në ankesë të subjektit politik LVV, në të cilën kanë pretenduar se nga postimi i kandidatës dhe nga përshkrimi i fotografisë, nuk mund të interpretohet se ka pasur thirrje eksplicite për votim, përmendje të drejtpërdrejtë të LVV-së e as orientim elektorale ndaj votuesve në ditën e votimit, sloganin zyrtar i LVV-së është "*Mos lëshoj pe!*" nuk e bën automatikisht çdo përdorim të shprehjes "*unë nuk lëshoj pe*" veprim fushate zgjedhore dhe se vetë prania në qendrën e votimit dhe shprehja personale e një qëndrimi individual nuk përbën shkelje zgjedhore, mirëpo për Panelin këto pretendime nuk qëndrojnë pasi që subjekti politik LVV në përgjigje në ankesë nuk ka bashkangjitur asnjë provë që do të dëshmonte të kundërtën e pretendimeve ankimore dhe provave të bashkangjitura nga pala ankuese. Andaj, pretendimet e tilla mbeten vetëm në nivel deklarativ dhe të pa argumentuara me prova konkrete.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryesuese e Panelit  
Hidajete Gashi-Alaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.